

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	03.01.2025	Kërkesë për informacion I nderuar zoti Kryetar Eol Çashku Në bazë të nenit 3, pika 1 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, kërkoj të më vihet në dispozicion informacioni për projektet e financuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë me Vendimin e Këshillit të Miratimit të Projekteve nr. 5, datë 24.12.2024 si më poshtë: 1. diploma e regjisorit të projektit “Vdekja le të pres”, paraqitur nga Producenti E**** T**** p.f. dhe distributori *****. 2. regjistrimi vjetor për vitin 2024 si producent i subjektit E**** T**** p.f. 3. regjistrimi vjetor për vitin 2024 si distributor i subjektit *****. 4. diploma e regjisorit të projektit “Lady D” paraqitur nga Producenti F**** K**** p.f. dhe distributori *****. 5. regjistrimi vjetor për vitin 2024 si producent i subjektit F**** K**** p.f. 6. regjistrimi vjetor për vitin 2024 si distributor i subjektit *****.	06.01.2025	E nderuar Zj. Th*****, Më datë 3 janar 2025, ju keni paraqitur një kërkesë, me mesazh e-mail, pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, ku, në kuadër të së drejtës së informimit, kërkonit të informoheni lidhur me: 1. diplomën e regjisorit të projektit “Vdekja le të pres”, që është paraqitur nga producenti Z.E**** T****, nëpërmjet shtëpisë kinematografike “*****”; 2. regjistrimin vjetor të producentit Z.E**** T****, për vitin 2024; 3. regjistrimin vjetor të distributorit “*****”, për vitin 2024; 4. diplomën e regjisorit të projektit “Lady D”, që është paraqitur nga producenti Z.F**** K****, nëpërmjet shtëpisë kinematografike “*****”; 5. regjistrimin vjetor të producentit Z.F**** K****, për vitin 2024; 6. regjistrimin vjetor të distributorit “*****”, për vitin 2024. Në lidhje me këtë kërkesë tuajën, ku ju bazoheni në ligjin me	Refuzuar	Nuk ka

		Mbetem me shpresë për një përgjigje nga ana juaj. E***** Th*****		N.119/2014, «Për të drejtën e informimit», të ndryshuar, ju sqarojmë se: Informacionet që ju keni kërkuar, të listuara më sipër, kanë të bëjnë qartësisht me sferën e të dhënave vetjake (personale) të këtyre individëve, të cilët, NUK ushtrojnë ASNJË detyrë apo funksion publik. Për rrjedhojë, këto të dhëna mbrohen, ndër të tjera, edhe nga «e drejta për një jetë private», e cila, është pjesë përbërëse e katalogut të të drejtave dhe lirive themelore e njeriut. Kjo e drejtë garantohet drejtpërsëdrejti nga Neni 35-2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 8-1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa 108+ “për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave vetjake (personale)” e Këshillit të Europës, dhe Ligji me №9887, datë 10.3.2008, «Për mbrojtjen e të dhënave personale», të ndryshuar. Këta individë, të përmendur më lart, kanë aplikuar pranë QKK-së, duke paraqitur dokumentacionin përkatës, si në formë të shtypshkruar ashtu edhe elektronikisht, brenda afateve të përcaktuara në njoftimin e datës 19 nëntor 2024, me nr. 437 prot, si dhe njoftimit për shtyrjen e afatit, të datës 27 nëntor 2024, me nr. 437/3		
--	--	--	--	---	--	--

			prot. Gjithashtu, ata janë regjistruar si producent dhe/ose si distributorë nëpërmjet portalit E-Albania, në shërbimet përkatëse të QKK-së, të cilat, ofrohen për këtë qëllim. Dokumentacioni që ata kanë paraqitur pranë QKK-së, e veçanërisht diplomat e tyre, të cilat ju i kërkon, janë mbledhur dhe përpunuar (terma ligjorë këto) nga ana e QKK-së për një qëllim shumë specifik, të qartë dhe legjitim (terma ligjorë edhe këto) me pëlqimin e bartësve të këtyre të drejtave, të cilët, janë individët e përmendur më lart. Qëllimi për çka këto të dhëna janë mbledhur e përpunuar kanë të bëjnë saktësisht vetëm me verifikimin, nga ana e komisionit të shqyrtimit paraprak të projekteve, i formuar pranë QKK-së, lidhur me përmbushjen, ose jo, të kriterëve formale detyruese nga ana e aplikantëve, sikundër sanksionohet në “rregulloren e përgjithshme të mbështetjes financiare dhe lejeve”, të ndryshuar, e cila është miratuar nga Kryetari i QKK-së, dhe protokolluar me numër 168, më datë 27 maj 2025. Në këto kushte, në bazë e në përputhje me Nenin 35-2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që sanksionon se: “Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit		
--	--	--	--	--	--

			bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”, dhe gërmën “b” të pikës 4, dhe pikës 2 të Nenit 5, të Konventës 108+ “për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave vetjake/personale” e Këshillit të Europës, që sanksionojnë se: “Çdo Palë do të garantojë që përpunimi i të dhënave mund të kryhet bazuar në pëlqimin e lirë, specifik, të informuar dhe të qartë të subjektit të të dhënave ose të ndonjë baze tjetër legjitime të përcaktuar me ligj. Të dhënat personale, që i nënshtrohen përpunimit, do të: ... mblidhen për qëllime të qarta, të specifikuara dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen në një mënyrë të papajtueshme me ato qëllime ...”, Qendra Kombëtare e Kinematografisë NUK mund t’ju vendosë në dispozicion ASNJË faksimile të diplomave të individëve të përmendur më lart, PA marrë më parë, shprehimisht, pëlqimin e tyre me shkrim, duke qenë se këto të dhëna NUK mund të përpunohen apo shpërndahen nga QKK-ja për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë mbledhur prej saj. Gjithashtu, i njejtë arsyetim dhe bazë ligjore vlen edhe lidhur me regjistrimin vjetor të producentëve dhe/ose distributorëve. Në qoftë se, individë të veçantë aplikojnë për t’u		
--	--	--	---	--	--

			regjistruar, ose jo, si producentë dhe/ose distributorë pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë është një çështje që ka të bëjë ekskluzivisht me jetën e tyre private (Neni 8-1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut). Për pasojë, edhe ky informacion mund të jepet nga ana e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë VETËM pasi të ketë marrë më parë, shprehimisht, pëlqimin e tyre me shkrim, duke qenë se, çdo aplikues e ka të qartë qysh në krye të herës se regjistrimi si producent dhe/ose si distributor realizohet VETËM qëllime të qarta, të specifikuara dhe të ligjshme, dhe NUK mund të përpunohen apo shpërndahen nga QKK-ja për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë mbledhur prej saj. Më në fund, sjellim në vëmendjen tuaj se, pika 1 e nenit 17, të ligjit me nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilit ju keni kërkuar QKK-së informacionin, sanksionon se: “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; ... Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat		
--	--	--	---	--	--

				“a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. ...”. Kërkesa juaj, lidhur me informacionet e përmendura më sipër, refuzohet.		
2	06.01.2025	Pershendetje, ne rradhe te pare Gezuar Vitin e Ri! Me vjen shume keq per pergjigjen negative per apkilimin tone, sepse takimi besoj shkoi shume mire dhe nuk patem ndonje kritike nga anetaret e jurise apo ndonje oponence te dukshme ne lidhje me skenarin, trajtimin apo edhe buxhetin qe nuk u diskutua nuk asnje moment, gje qe na bere shume optimist ne ate moment. Te lutem kur mund te kaloj te marr rezultatet dhe piket e marra ne konkurim, sepse mesa pashe ne web e QKK nuk kishte gje. Ne pritje, Faleminderit R**** C***** Administrator	07.01.2025	I nderuar Z. Canameri, Vlerësimi i anonimizuar me pikë i projektit tuaj është si më poshtë: Antari 1 – 33 pikë Antari 2 – 25 pikë Antari 3 – 26 pikë Antari 4 – 33 pikë Antari 5 – 41 pikë Totali – 158 pikë nga 500 të mundshme. Në qoftë se dëshironi, fletët e votimit të projektit tuaj mund t’i konsultoni fizikisht të anonimizuara pranë QKK-së duke u paraqitur qysh prej javës së ardhshme. Me respekt, Qendra Kombëtare e Kinematografisë	E plotë	Nuk ka

3	09.01.2025	KËRKESË PËR INFORMACION Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, Kryetarit Eol Çashku Për dijeni, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Përsëndetje, Emisioni “Artes” është duke përgatitur një analizë të punës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në tre vitet e fundit. Në vijim po shtroj disa kërkesa që, në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, jeni të lutur t’u përgjigjeni. 1.Mbi çfarë strategjie po funksionon puna në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë? Jeni të lutur të na vini në dispozicion dokumentin e strategjisë që e shpalli fitues kryetarin aktual të QKK-së, z. Eol Çashku, në garën për drejtimin e QKK-së. 2. Sa është buxheti i QKK-së për vitin 2024? Si është shpërndarë ai për secilën nga kategoritë e filmave? 3. Sa premiera filmike ka pasur gjatë tre viteve të fundit? Në sa kinema kanë qarkulluar, sa ditë kanë qëndruar, sa publik kanë pasur? 4.Sa të rinj deri në moshën 35-vjeçare janë financuar nga QKK? 5.Në cilat festivale brenda dhe jashtë vendit kanë marrë pjesë filmat shqiptarë?	17.01.2025	E nderuar Znj. D***, Më poshtë gjeni informacionin që kërkohet prej jush. Pyetja 1 Mbi çfarë strategjie po funksionon puna në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë? Jeni të lutur të na vini në dispozicion dokumentin e strategjisë që e shpalli fitues kryetarin aktual të QKK-së, z. Eol Çashku, në garën për drejtimin e QKK-së. Përgjigja 1 Platforma e Kryetarit të QKK-së, gjendet në këtë URL: https://qkk.al/wp-content/uploads/2023/06/Platforma_QKK_2024_Eol_Cashku.pdf Pyetja 2 Sa është buxheti i QKK-së për vitin 2024? Si është shpërndarë ai për secilën nga kategoritë e filmave? Përgjigja 2 Buxheti i QKK-së për vitin kalendarik 2024 është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ligjit me №97/2023, «Për buxhetin e vitit 2024», të ndryshuar. Ky ligj gjendet i botuar në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare, në URL-në: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2023/12/07/97. Informacioni për buxhetin e QKK-	E plotë	Nuk ka
---	------------	---	------------	---	---------	--------

		Nga sa publik janë ndjekur? A kanë qarkulluar në televizione të huaja? 6. Sa festivale ka financuar QKK në vitet e fundit? Sa ka qenë vlera financiare për secilin festival? Sa ka qenë numri i spektatorëve për secilin festival? 7. Mbi çfarë rregulloreje po funksionon aktualisht QKK? Jeni të lutur të vini në dispozicion dokumentin. 8. Mbi cilat kritere një projekt dhe një aplikant konsiderohet korrekt për të hyrë në garën e projekteve artistike? 9. Si bëhet aktualisht vlerësimi i projekteve nga Këshilli i Projekteve Artistike të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë? 10. Sa është buxheti total i QKK-së për vitin 2025 dhe sa ai për projekte? Falemnderit paraprakisht, E*** D*** Gazetare, autore e emisionit “Artes” Radio Televizioni Shqiptar		së, për vitin kalendarik 2024, gjendet në faqen 12, 14, 17 dhe 40 të dokumentit në URL-në e mësipërme. Kodi i QKK-së, në këto, tabela është numri 57. Lidhur me shpërndarjen e këtij fondi nëpër kategori të caktuara, ky informacion gjendet në faqen 7, të «Raportin mbi veprimtarinë vjetore 2024», të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Ky raport gjendet në URL-në: https://qkk.al/raporte-mbi-veprimtarine-vjetore-te-qkk/raport-mbi-veprimtarine-vjetore-2024/. Gjithashtu, këto shifra gjenden edhe në vendimet e këshillave miratues të projekteve, të cilat, janë publikuar në faqen e internetit të QKK-së, në këtë URL: https://qkk.al/rezultatet-e-konkurimeve-per-projekte-kinematografike/rezultatet-e-konkurimeve-per-projekte-kinematografike-per-vitin-2024/. Pyetja 3 Sa premiera filmike ka pasur gjatë tre viteve të fundit? Në sa kinema kanë qarkulluar, sa ditë kanë qëndruar, sa publik kanë pasur? Përgjigja 3 Në vitin 2021 janë shfaqur 19 premiera. Në vitin 2022 janë shfaqur 20 premiera.	
--	--	--	--	---	--

				Në vitin 2023 janë shfaqur 9 premiera. Në vitin 2024 janë shfaqur 10 premiera. Është detyrim kontraktual për producentët që, veprat filmike premierë të shfaqen për të paktën një javë, në sallën ku është shfaqur premiera. Në vitin e fundit, atë 2024, Kryetari i QKK-së ka bërë përpjekje të vazhdueshme, në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore, për të detyruar kinematë që të veprojnë sipas dispozitave përkatëse ligjore lidhur me: (i) regjistrimin vjetor të distributorëve dhe/ose difuzorëve prej QKK-së, përpara ushtrimit të veprimtarisë së tyre; (ii) dhënien e lejeve të qarkullimit, për filmat shqiptarë, të cilët, shfaqen dhe/ose transmetohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; (iii) dhënien e faturave tatimore për çdo individ që merr pjesë në një shfaqje filmi; (iv) kryerjen e raportimit prej kompanive, që zotërojnë salla kinemaje, lidhur me numrin e biletave të shitura, fitimi i realizuar, etj. Vetëm Cineplexx e ka furnizuar me të dhëna të plota QKK-në, lidhur me veprimtarinë e saj për vitin 2024. Kjo është hera e parë, qysh prej miratimit të ligjit për kinematografinë që		
--	--	--	--	--	--	--

			raportohet nga një kinema. Shënojmë se, kinematë e tjera ende NUK kanë raportuar. QKK vendos në dispozicionin tuaj këto të dhëna, të raportuara nga Cineplexx, për vitin 2024, lidhur me shfaqjen e filmave që QKK-ja ka financuar. - Filmi i kategorisë koproduksion në pakicë «Lights Fall», me regji të Sven Dragonës dhe Phedon Papamichail, është shfaqur në 2 salla të Cineplex përgjatë muajit Prill 2024. Biletat e shitura janë 36. - Filmi artistik me metrazh të gjatë, vepër e parë ose e dytë, «Legjenda e bastunit», me regji të Xhoslin Rama, është shfaqur në 2 salla të Cineplex përgjatë muajve Maj dhe Qershor 2024. Biletat e shitura janë 452. - Filmi artistik me metrazh të gjatë «Pikë uji», premierë, me regji të Robert Budina, është shfaqur në 2 salla të Cineplex përgjatë muajve Shtator dhe Tetor 2024. Biletat e shitura janë 702. Pyetja 4 Sa të rinj deri në moshën 35-vjeçare janë financuar nga QKK? Përgjigja 4 2024 Grup mosha deri në 35 vjeç 5 regjisorë Grup mosha deri nga 36 vjeç deri në 55 vjeç 4 regjisorë		
--	--	--	--	--	--

				Grup mosha deri mbi 55 vjeç 7 regjisorë Në lidhje me vitet e tjera, momentalisht, nuk kemi statistika, duke qenë se QKK-ja nuk ka një strukturë të posaçme për këtë gjë. Shënojmë se, ka nisur procesi i rishikimit dhe miratimit të organikës që parashikon një strukturë të tillë. Pyetja 5 Në cilat festivale brenda dhe jashtë vendit kanë marrë pjesë filmat shqiptarë? Nga sa publik janë ndjekur? A kanë qarkulluar në televizione të huaja? Përgjigja 5 2022 • Konkursim zyrtar në Tallin Black Nights Film Festival, Estoni, i filmit «Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur», regjia Gentian Koçi. • Përzgjedhje në sesionin «Zgjedhjet e Kritikeve», në Tallin Black Nights Film Festival i filmit «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo», regjia Fatmir Koçi. • Konkursim zyrtar në Cottbus Film Festival i filmit «Nji prej nesh», regjia Ergys Meta. • Konkursim zyrtar dhe vlerësim me çmime për filmin «Virgjëresha Shqiptare» (Minority Co-production), regjia Bujar Alimani; • Euromillions Audience Awards në Ostende Film Festival, Belgjikë;		
--	--	--	--	---	--	--

			• Best Balkan Film - Vjosa Berisha Award në Prishtina International Film Festival. • Konkurrir zyrtar dhe vlerësim me çmimin International Ingmar Bergman Award, në Goteborg Film Festival për filmin «Vera andrron detin», regjia Kaltrina Krasniqi. • Konkurrir zyrtar i filmit «Internimi», regjia Kast Hasa, në edicionin e XV të festivalit të filmit «Hyjnesha në Fron», ku u vlerësua me çmimet: • Filmi më i mirë; • Aktori më i mirë. • Konkurrir zyrtar i filmit «Portreti i pambaruar», regjia Namik Ajazi fiton 3 çmime në Cilento International Film Festival: (a) Çmimi Filmi ndërkombëtar më i mirë; (b) Çmimi për Fotografinë më të mirë; (c) Çmimi aktorja më e mirë jo-protagoniste. • Konkurrir zyrtar i filmit «Pasojat e lirisë», regjia Lorin Terezi, fiton çmimin Projekti me i mirë në Cypros Film Days International Film Festival. • Konkurrir zyrtar i projektit filmik «After Dark», i regjisorit Erenik Beqiri, fiton çmimin Region Sud Prize në Mediterranean Co-production Forum, Marseille. 2023 • Filmi me metrazh të gjatë «Nji prej nesh», me skenar e regji të Ergys		
--	--	--	---	--	--

				Meta, fitoi 3 çmime në festivalin «Hyjnesha në fron» në Kosovë: (a) Filmi më i mirë; (b) Regjisor i më i mirë, Ergys Meta; (c) Aktori më i mirë, Alban Ukaj. - Filmi me metrazh të shkurtër «Sheets», me regji të Evi Gjonit, shpallet si filmi më i mirë i shkurtër në Athens Short Film Festival 2023, dhe si filmi më i mirë i shkurtër i Europës lindore në Link International Film Festival 2023. - Filmi «Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur», me regji të Gentian Koçit, i akordohet çmimi «Fischer Audience Award – Open Horizons» prej festivalit prestigjioz «Thessaloniki International Film Festival». - Filmi dokumentar «Edhe një ditë», regjia Eneosa Carka, përzgjidhet mes 23 filmave në «International Documentary Film Festival Amsterdam (IDFA)», në seksionin «Luminous». - Sudabeh Mortezaei, skenaristja dhe regjisorja e filmit «Europa», pranohet të konkurrojë në Festivalin e Filmit në Sarajevë. Ky film u xhirua në Poliqan dhe Berat në pranverën e 2022, në bashkëpunim me ERAFILM PRODUCTIONS. - Filmi «Sirin» me regji nga Senad Sahmanovic dhe skenar të Claudia Bottino, u shfaq mbrëmë për herë të parë në ekranin e madh (Open air		
--	--	--	--	---	--	--

			Cinema), në edicionin e 29-të të Festivalit të Sarajevës. Sirin është prodhuar nga CUT UP, Sekvenca, On Film Production, BUKA, Dokument, APC, dhe është mbëtetur financiarisht nga Qendra Malazeze e Filmit, Qendra Kroate e Audiovizualit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Qendra Kinematografike e Kosovës, Fondacioni Kinematografik i Sarajevës dhe Eurimages. 2024 • Filmi artistik me metrazh të gjatë «Pikë Uji», regjia Robert Budina, producente Sabina Kodra, mban premierën ndërkombëtare në Festivalin Ndërkombëtar të filmit të Varshavës. Ky film u përzgjedh si përfaqësues i Shqipërisë në çmimet Oscars 2025;. • Filmi Dokumentar «Another Day» / «Një tjetër ditë», regjia Eneos Çarka; fiton çmimin «Balkan Dox Award» në Dokufest, Prizren, Kosovë. • Filmi artistik «Yje të së ardhmes», skenari dhe regjia Edmond Topi, fiton çmimin «Filmi më i Mirë Ndërkombëtar» në festivalin e filmit «Castelli Romani» 2024 (CroFFi), Romë, Itali; • Filmi «Hatixhja dhe Shabani», me regji nga Visar Morina, ndër 31 projekte fitues në skemën e financimit «Co-Production Support» të Eurimages. Aktualisht në xhirime;		
--	--	--	--	--	--

			• Konkursim zyrtar i projektit filmik «Pas errësirës» / «After Dark», i regjisorit Erenik Beqiri fiton çmimin «Region Sud Prize» në Mediterranean Co-production Forum, Marseille; • Filmi artistik me metrazh të gjatë «Këtu vallëzohet me hijet», regjia Pluton Vasi dhe prodhim i shtëpisë kinematografike «Artfilm», fiton çmimin «Best Production» në «International World Film Awards»; • Filmi artistik me metrazh të gjatë «Luna Park», regjia Florenc Papas, prodhim i shtëpisë kinematografike On Film Production, përzgjidhet si «Official Selection» në Edicionin e 55 të International Film Festival of India, Goa; Qendra Kombëtare e Kinematografisë NUK i disponon të dhënat lidhur numrin e pjesëmarrjes së publikut për t'i ndjekur ato, apo në qoftë se ato kanë qarkulluar në televizione të huaja. Pyetja 6 Sa festivale ka financuar QKK në vitet e fundit? Sa ka qenë vlera financiare për secilin festival? Sa ka qenë numri i spektatorëve për secilin festival? Përgjigja 6 Viti 2022 «Tirana International Film Festival 2022, Edicioni 20» është financuar në masën 3.800.000 lekë.		
--	--	--	---	--	--

				«Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, IHRFFA 2022» është financuar në masën 1.500.000 lekë. «AniFest 22» është financuar në masën 2.100.000 lekë. «Dea Open Air – International Film Festival Edicioni IX» është financuar në masën 1.500.000 lekë. «Festivali i Filmit Ballkanik dhe Kulinarisë – Edicioni XII» është financuar në masën 2.100.000 lekë. «Open Cinema Edicioni V» është financuar në masën 2.200.000 lekë. «Korça Short Film Festival 2022» është financuar në masën 1.600.000 lekë. Viti 2023 «Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, IHRFFA 2023» është financuar në masën 1.600.000 lekë. «Festivali i Filmit Ballkanik dhe Kulinarisë – Edicioni XIII» është financuar në masën 2.600.000 lekë. «AniFest 23» është financuar në masën 2.600.000 lekë. «Open Cinema edicioni VII» është financuar në masën 2.800.000 lekë. «Korça Short Film Festival 2023» është financuar në masën 1.800.000 lekë. «48 Hour Film Festival» është financuar në masën 1.000.000 lekë. Viti 2024 «Tirana International Film Festival» është financuar në masën 2.400.000 lekë.		
--	--	--	--	--	--	--

				«Festivali i Filmit Ballkanik & Kulinarisë» është financuar në masën 2.100.000 lekë. «Festivali DEA Open Air» është financuar në masën 2.100.000 lekë. «Tirana 48 hour film project» është financuar në masën 1.000.000 lekë. «Ditë filmi kombëtar & ndërkombëtar në formatin “OPEN CINEMA”» është financuar në masën 1.800.000 lekë. «Festivali “Dropull International Film Festival – Ura e miqësisë”» është financuar në masën 1.000.000 lekë. «Festivali “Korça Short Film Festival”» është financuar në masën 1.800.000 lekë. «Festivali “AniFest Rozafa & Argjiro 2024”» është financuar në masën 1.800.000 lekë. Të dhënat lidhur me numrin e pjesëmarrësve, për vitin 2024, do të kërkohen në aplikimet që do të realizohen gjatë vitit 2025. «Tirana International Film Festival» ka vetëdeklaruar: • 20 mijë pjesëmarrës online dhe 3 mijë pjesëmarrës fizikisht në vitin 2020. • 25 mijë pjesëmarrës fizikisht në vitin 2021. «Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, IHRFFA» ka vetëdeklaruar: • 1500 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2020.		
--	--	--	--	--	--	--

			• 2500 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2021. • 2500 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2022. «Festivali DEA Open Air» nuk e ka deklaruar pjesëmarrjen. «Festivali i Filmit Ballkanik dhe Kulinarisë» ka vetëdeklaruar 5000 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2021. «Open Cinema» nuk e ka deklaruar pjesëmarrjen. «Festivali “Korça Short Film Festival”» ka vetëdeklaruar 1200 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2021. «AniFest» ka vetëdeklaruar: • 1200 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2020. • 1900 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2021. • 1900 pjesëmarrës fizikisht në vitin 2022. «Tirana 48 hour film project» nuk e ka deklaruar pjesëmarrjen. «Festivali “Dropull International Film Festival – Ura e miqësisë”» nuk e ka deklaruar pjesëmarrjen. Pyetja 7 Mbi çfarë rregulloreje po funksionon aktualisht QKK? Jeni të lutur të vini në dispozicion dokumentin. Përgjigja 7 Qysh prej muajit Maj 2024, QKK funksionon mbi bazën e tri rregulloreve:		
--	--	--	--	--	--

			(i) «Regullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», e cila gjendet në URL-në: https://qkk.al/rregulloret-e-qkk/rregullore-e-brendshme-e-organizimit-dhe-funksionimit-te-qkk/. (ii) «Regullore e përgjithshme e mbështetjes financiare dhe lejeve», e ndryshuar, e cila gjendet në URL-në: https://qkk.al/index.php/rregulloret-e-qkk/rregullore-e-pergjithshme-e-mbeshtetjes-financiare-dhe-lejeve/. (iii) «Kodi i sjelljes dhe etikës në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë», e cila gjendet në URL-në: https://qkk.al/index.php/rregulloret-e-qkk/kodi-i-sjelljes-dhe-etikes-ne-qkk/. Pyetja 8 Mbi cilat kritere një projekt dhe një aplikant konsiderohet korrekt për të hyrë në garën e projekteve artistike? Përgjigja 8 Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, formale, të pranueshmërisë së projektit parashikohen prej krerëve IV, V, VI dhe VII të «Regullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve», të ndryshuar, e cila gjendet në URL-në: https://qkk.al/index.php/rregulloret-e-qkk/rregullore-e-pergjithshme-e-mbeshtetjes-financiare-dhe-lejeve/.		
--	--	--	--	--	--

				Gjithashtu, një nga kriteret e përgjithshme, formale, të pranueshmërisë së projektit parashikohen nga pika A.1.2/11 e «Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë», e cila gjendet në URL-në: https://qkk.al/rregulloret-e-qkk/rregullore-e-brendshme-e-organizimit-dhe-funksionimit-te-qkk/. Kjo ka të bëjë me faktin që, çdo aplikant, i cili, paraqet për konkurrim projekte pranë QKK-së, duhet domosdoshmërisht që, të paktën, një jetë pranuar si konkurrent në ndonjë festival të akredituar (A) nga FIAPF, ose të ketë ftuar ndonjë çmim prej tyre. Pyetja 9 Si bëhet aktualisht vlerësimi i projekteve nga Këshilli i Projekteve Artistike të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë? Përgjigja 9 Këshillat miratues të projekteve, pranë QKK-së, kryejnë vlerësime me pikë, sipas fletëve të votimit, të cilat, janë të publikuara paraprakisht në faqen zyrtare të internetit të QKK-së, në URL-në: https://qkk.al/flete-votimi-kmp-2024/. Pyetja 10		
--	--	--	--	--	--	--

				Sa është buxheti total i QKK-së për vitin 2025 dhe sa ai për projekte? Përgjigja 10 Buxheti i QKK-së për vitin kalendarik 2025 është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ligjit me №115/2024, «Për buxhetin e vitit 2025». Ky ligj gjendet i botuar në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare, në URL-në: http://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/12/03/115. Informacioni për buxhetin e QKK-së, për vitin kalendarik 2025, gjendet në faqen 21 dhe 43 të dokumentit në URL-në e mësipërme. Kodi i QKK-së, në këto, tabela është numri 57.		
4	10.01.2025	Kërkesa është sjellë në skedar PDF, e cila, i është attach-uar një mesazhi e-mail. Për arsye të rezolucionit shumë të ulët është vendosur skedari origjinal në këtë URL: http://qkk.al/wp-content/uploads/2025/01/e-th.pdf	23.01.2025	E nderuar Znj. Thomaraj, Ju falënderojmë për kërkesën tuaj të datës 10 janar 2025 , si dhe shkresës me № 26 prot., të datës 13.01.2025, dhe për interesin që tregoni për transparencën dhe qartësinë. Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë: 1. Referuar kërkesës suaj për informacion mbi «titullin e përcaktuar në diplomë», «numrin e diplomës» dhe «datën e lëshimit të diplomës» për individët Edmond Topi dhe Fatmir Koçi: Kërkesat për informacion si titulli i diplomës, numri dhe data e lëshimit janë të dhëna vetjake (personale) që mbrohen nga:	Kufizuar	Nuk ka

			o Ligji Nr. 119/2014 ndryshuar “Për të drejtën e informimit”, ky ligj i garanton individëve të drejtën për të kërkuar dhe marrë informacion nga organet publike dhe përcakton për cilët individë mund të kërkojnë të dhëna personale. o Neni 35 § 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe kërkon pëlqimin e individit për mbledhjen, përdorimin apo publikimin e tyre; o Konventa 108+ e Këshillit të Europës, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave vetjake (personale)» e Këshillit të Europës, në nenin 2 (a) sanksionon se: «me “të dhëna vetjake (personale)” kuptohet çdo informacion që ka lidhje me një individ të identifikueshëm ose që mund të identifikohet (“subjekt i të dhënave”). o Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, që përcakton kuptimin e të dhënave personale, kufizimet dhe detyrimet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Dokumentacioni i paraqitur pranë QKK-së, e veçanërisht diplomat e tyre, të cilat ju i kërkon, janë mbledhur dhe përpunuar nga ana e QKK-së për një qëllim shumë specifik, të qartë dhe		
--	--	--	---	--	--

				legjitim me pëlqimin e bartësve të këtyre të drejtave, të cilët, janë individët e përmendur më lart. Qëllimi për çka këto të dhëna janë mbledhur e përpunuar ka të bëjë saktësisht vetëm me verifikimin, nga ana e komisionit të shqyrtimit paraprak të projekteve, i formuar pranë QKK-së, lidhur me përmbushjen, ose jo, të kriterëve formale detyruese nga ana e aplikantëve, sikundër sanksionohet në «rregulloren e përgjithshme të mbështetjes financiare dhe lejeve», të ndryshuar, e cila është miratuar nga Kryetari i QKK-së, më datë 27 maj 2024, dhe protokolluar me №168 të protokollit. 2. Referuar kërkesës suaj për informacion mbi datat e regjistrimit të producentëve dhe distributorëve: Sipas rregullores së përgjithshme të mbështetjes financiare dhe lejeve të QKK-së (miratuar më 27 maj 2024, Nr. Prot. 168), producentët: - o Z. Edmond Topi është regjistruar më datë 30 maj 2024, nëpërmjet subjektit «MMS Nositi shpk». - o Z. Fatmir Koçi është regjistruar më datë 20 gusht 2024, nëpërmjet subjektit «KKOÇI PRODUCTIONS shpk». - o Betina Goldman/ONE EYED FILMS ka një marrëveshje me «KKOÇI PRODUCTIONS shpk» i cili është një producent i regjistruar pranë QKK-së.		
--	--	--	--	---	--	--

			Kjo do të thotë se aplikimi për mbështetje financiare është i mundur vetëm për KKOÇI PRODUCTIONS shpk, pasi ky është producenti që ka të drejtën për të aplikuar, dhe distributorët, siç është Betina Goldman/ONE EYED FILMS, nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare sipas kësaj rregulloreje. 3. Referuar kërkesës suaj për një faksimile të procesverbaleve të komisionit të shqyrtimit paraprak: Bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, gjeni faksimilet e procesverbaleve për kategoritë: - o Post-produksion dhe distribucion. - o Film i animuar. Ju sigurojmë se Qendra Kombëtare e Kinematografisë mbetet në vazhdim e përkushtuar dhe bën përpjekje maksimale për të garantuar transparencë të plotë. Me respekt, Eol Çashku		
--	--	--	--	--	--